

LIGJ
Nr.7384, datë 8.5.1990

**PËR DISAS NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.7174, DATË 20.11.1987 “PËR ORGANIZIMIN
GJYQËSOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 67 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në dekretin nr.7174, datë 20.11.1987 “Për organizimin gjyqësor të RPSSH, bëhen këto ndryshime:

Në nenin 12 pas fjalës “përbëhet” hiqen fjalët “nga gjykatat e fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve”.

Neni 2

Në nenin 15, në paragrafin e parë, pas fjalëve “çështjet penale e civile”, hiqen fjalët “me përjashtim të atyre që me ligj janë lënë në kompetencë të gjykatave të fshatrave, të qyteteve dhe lagjeve të qyteteve”, kurse paragrafi i dytë i këtij neni, shfuqizohet.

Neni 3

Nenet 13 dhe 14, shfuqizohen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi më 1 nëntor 1990.

SEKRETARI I PRESIDIMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
SIHAT TOZAJ

KRYETARI I PRESIDIMIT TË KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË
RAMIZ ALIA